



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Punileno / Predato Received / Delivery	26.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKIMSHTAK	Shtesa / Puteq Appendix	Sasia Kolicana Quantity
	2006/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.155/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 19.03.2021 me numër A.nr.155/2021, e parashtruar përmes përfaqësueses së autorizuar avokates me adresë lagjja Ulpiana D2 hymja 1/1 nr.5, në Komunë të Prishtinës, për ankuesen kundër Vendimit nr.316-KA-2020 Të protokolluar me nr.03/02-33 të datës 18.01.2021 të Komisionit për Ankesave të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.155/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e sistemuar në pozitë “vizatues teknik”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve-Departamentin për Shërbime Mbështetëse/Sektori i Inxhinjeringut, në Policinë e Kosovës, sipas Kontratës së punës të datës 11.09.2015, i cili me datë 16.10.2020 ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagesës shtesë së inxhinjeringut prej 250 euro dhe rritjen e koeficientit të pagës, e cila për mes shkresës zyrtare E-mailit të datës 22.10.2020 ka pranuar përgjigjen lidhur me kërkesën e saj. E pa kënaqur me këtë përgjigje me datë 10.11.2020 nr.3616-KA-20200 ka parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave në Policinë e Kosovës, i cili me datë 18.01.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 03/02-33 për lëndën 316-KA-2020, me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur këtë çështje duke udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës, të cilin vendim ankuesi e ka pranuar me datë 19.01.2021, duke nënshkruar pranimin e tij në faqen e fundit të vendimit.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 18.01.2021 numër protokollit 03/02-33, ka parashtruar ankesë me datë 19.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.03.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Ndërsa më datë policia e Kosovës përmes shkresës së datës 15.04.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: **Ankesë e ankuesit A.nr.155/2021 me numër protokollit 1265/2021 të datës 19.03.2021** e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datë 16.10.2020 për kompensim të pagës shtesë të inxhinjeringut, prej 250 euro; Vendimi i datës 18.01.2021 numër protokollit 03/02-33 i Komisionit të Ankesave në Policinë e Kosovës; E-mail i datës 23.10.2020; E-mail i datës 22.10.2020; Kontratë e punës e datës 11.09.2015 me numër ref.07/1-01A/0944; Kontratë e punës e datës 11.09.2015 me numër ref.07/1-01A/0850; Njoftim i datës 15.06.2015; **Përgjigje në ankesë e datës 15.04.2021 me numër protokollit 1804/2021 nga Policia e Kosovës**, E-mail i datës 31.03.2021 Ankesë e datës 10.11.2020 e Komisionit të Ankesave në Policinë e Kosovës; E-mail i datës 18.02.2021, prej 1-3 faqe

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që me datë 19.01.2021 ka pranuar Vendimin e datës 18.01.2021 me numër protokollit 03/02-33 e Komisionit të Ankesave, të Policisë së Kosovës, me pretendime ankimore për kompensim të shtesë së inxhinjeringut dhe rritjen e koeficientit të pagës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja Vendimin e datës 18.01.2021 me numër protokollit 03/02-33 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, e ka pranuar me datë 19.01.2021, kurse me datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesën me numër 1265/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, dhe se ankuesja për realizimin e të drejtës së saj është udhëzuar për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 24 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankueses i ka filluar ti rrjedh afati për ankimim, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë kur ankuesja e ka pranuar Vendimin e datës 18.01.2021 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, ku në shkresat e lëndës është gjetur se ankuesja vendimin e ka pranuar me datës 19.01.2021, duke u bazuar në dëshmitë e dorëzuara në Këshill nga të dy palët, ku vërtetohet se ankuesja e ka nënshkruar pranimin e vendimit me datë 19.01.2021.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankueses është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuara në nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të ankueses, por ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankueses të datës 19.03.2021 me numër A.nr.155/2021 të protokolluar me nr.1265/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.155/2021, datë 26.04.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësueses së autorizuar, Avokates (për ankuesen.);
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore/Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



7